**VENDIM**
**Nr. 520, datë 7.9.2023**

# PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 893, DATË 17.12.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË ORGANIZIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË KABINETEVE NDIHMËSE, TË ORGANIZIMIT TË BRENDSHËM TË INSTITUCIONEVE TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE, SI DHE PËR PROCEDURAT E HOLLËSISHME PËR PËRGATITJEN, PROPOZIMIN, KONSULTIMIN DHE MIRATIMIN E ORGANIZIMIT TË BRENDSHËM", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17, pika 2, 21, pika 5, e 29, pika 1, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 893, datë 17.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Pikat 29/1, 29/2, 29/3 dhe 29/4 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"29/1. Në ministritë e linjës, sipas përcaktimit të strukturës dhe organikës së tyre, krijohen "Qendrat e inovacionit dhe ekselencës", të dedikuara:

a) për të identifikuar koncepte, procese novatore dhe teknika të reja, në përputhje me politikat e ministrisë, për të kryer studime dhe analiza krahasuese mbi politikat në nivel rajonal e botëror, për të analizuar të dhënat në kuadër të hartimit apo zbatimit të politikave të ndërmarra nga ministria, me qëllim zhvillimin e analizave strategjike për të zbuluar mundësi të reja inovacioni;

b) për të propozuar dhe për të menaxhuar projekte apo iniciativa zhvillimore në fushat përkatëse;

c) për të kontribuar me njohuri dhe ekspertizë të posaçme të nevojshme për një periudhë të caktuar kohore në fushën që mbulon institucioni dhe për të cilën mungojnë kapacitetet e nevojshme në institucion.

29/2. Numri i pozicioneve të punës në "Qendrat e inovacionit dhe ekselencës", të krijuara sipas pikës 29/1, të këtij vendimi, të jetë jo më shumë se 6 (gjashtë). Në përbërje të qendrave të ketë një drejtues të qendrës dhe ekspertët sipas fushave përkatëse.

29/3. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve në "Qendrat e inovacionit dhe ekselencës" të rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

29/4. Procesi i përzgjedhjes së kandidatëve për punësim në "Qendrat e inovacionit dhe ekselencës" të realizohet nëpërmjet procedurave konkurruese me shpallje publike, në përputhje me kriteret e përcaktuara në përshkrimet e punës.".

2. Pika 29/5 shfuqizohet.

II. Ngarkohen Departamenti i Administratës Publike dhe ministritë e linjës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**